



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
Kryesia

Nr. 247 prot.

Tiranë, më 05.03.2020

Urdhër

Nr. 8 datë 05.03.2020

Për mënyrën e përgatitjes dhe realizimit të veprimtarive shkencore sipas programit e kalendarit të ASHSH

I. Programi vjetor dhe kalendarët mujorë të veprimtarive shkencore të ASHSH kanë vlerën e një urdhri administrativ.

Programi vjetor dhe kalendarët mujorë të veprimtarisë së Akademisë së Shkencave u bëhen të njohura si akte rregullatorë të punës së tyre:

1. Kryetarëve të seksioneve;
2. Kryetarëve të komisioneve shkencore;
3. Seksioneve përkatëse të shërbimeve administrative (sektorit të financës, sektorit të burimeve njerëzore, sektorit të botimeve dhe bibliotekës, zyrës së marrëdhënieve me publikun dhe me jashtë);
4. Personave të përmendur nominalisht në program e kalendar.

Ngarkohen për qarkullimin e tyre në të gjitha zyrat e përmendura në pikat 1-4 më sipër: sekretaria e Kryesisë dhe asistentet e seksioneve. Të gjitha komunikimet njoftuese e koordinuese me komisionet bëhen përmes tyre.

II. Dokumentacioni i detyrueshëm për miratim për realizimin e veprimtarive të parashikuara në program dhe kalendar duhet të përmbajë:

1. *Kalendarin e veprimtarisë: përgatitet nga Seksioni (gjegjësisht komisioni);*
2. *Programin e plotë të veprimtarisë, listën e të ftuarve dhe të pjesëmarrësve: Përgatitet nga Seksioni (gjegjësisht komisioni).*


3. Preventivin financiar për shpenzimet që parashikohen për realizimin e veprimtarisë në program / kalendar dhe mbështetjen logjistike të saj. Përgatitet nga sektori i financës.

III. Dokumentacioni i përshkruar në pikat 1-3 i paraqitet sekretarit shkencor, i cili, pas shqyrtimit të tij, ia paraqet për marrje pëlqimi Kryetarit / Kryesisë.

Për zbatimin e këtij akti ngarkohen sekretari shkencor i ASHSH, kryetarët e seksioneve dhe kryetarët e komisioneve.

Ky urdhër hyn në veprim menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI


Kryetar